



Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitetet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	31.03.2020
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-27

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Prizren, më 31.03.2020

Në mbështetje të Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke u bazuar në nenin 23 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 12.03.2020, mori këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për Procedurat dhe Masat për Përpunimin dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë edhe Rregullorja e sipërhënuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më, 12.03.2020 me qëllim që të përcaktohet baza ligjore me të cilën përcaktohen procedurat dhe masat për përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Kryesues i Këshillit Drejtues


Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menxhmentit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrës Ligjore;
- Arkivit.